

Master Ekzekutiv në "Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Territorial i Zonave Rurale"

(120 ECTC, 2 vite akademike me kohë të plotë)

Profili profesional (PËRSHKRIMI I DEGËS)

Programi i studimeve të ciklit të tretë është masteri ekzekutiv në "Planifikim dhe zhvillim ekonomik territorial i zonave rurale" i cili u hap për herë të parë në vitin akademik 2020-2021, duke e shndërruar kështu departamentin, një ndër të vetmit që ofron një program të tillë studimi në të gjithë arsimin e lartë në vend. Ky program i drejtohen profesionistëve të cilët duan të thellojnë njohuritë e tyre dhe të kontribuojnë në kërkimin shkencor në fushën e Politikave të zhvillimit rural dhe organizimit të territorit.

Masteri ekzekutiv "Planifikim dhe zhvillim ekonomik territorial i zonave rurale" i drejtohet politik bërësve të cilët duan të rrisin njohuritë e tyre me informacione dhe metodologji të reja në fushën e organizimit dhe zhvillimit ekonomik të territoreve. Ky program studimi i hartuar me mbështetjen e universiteteve evropiane gjermane, franceze, dhe greke, lider në këto fusha, është një program studimi unik në Shqipëri si për sa i përket tematikës që ofron ashtu edhe për sa i përket publikut të cilit i drejtohet. Ky program studimi ka 120 kredite dhe zgjat të paktën 2 vjet. Në fund të studimeve jepet Diploma Master Ekzekutiv.

Në studimet e ciklit të tretë të ofruara nga departamenti i "Ekonomisë dhe politikave të zhvillimit Rural", do të pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i Shkencave" dhe që plotësojnë kritere të tjera të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

Formim i përgjithshëm

1. Institucionet dhe aktorët në territor Analysis of Agriculture and Food Policies

b. Formim baze karakterizues

1. Inovacioni dhe Aksionet territoriale
2. Politikat e zhvillimit rural
3. Ekonomia e Burimeve natyrore dhe mjedisit
4. Politikat e BE dhe Kohezioni territorial
5. Administrimi territorial, planifikimi dhe qeverisja territoriale
6. Administrimi i te dhënave dhe metodat gjeoinformatike
7. Sipërmarrja dhe menaxhimi i bizneseve locale
8. Marketingu territorial

c. Formim integrues.

1. Hartimi, përgatitja dhe vlerësimi i projekteve
2. Instrumentet dhe metodat e vlerësimit të politikave

Mundësitë për punësim

Na

PROGRAMI MËSIMOR

Vit, Semestri	Nr	Lendet	Kreditet
Viti i pare, Semestri i pare (1)	1	Institucionet dhe aktoret në territor	8
	2	Inovacioni dhe Aksionet territoriale	8
	3	Politikat e zhvillimit rural	7
	4	Ekonomia e Burimeve natyrore dhe mjedisit	7
Viti i pare, Semestri i dyte (2)	1	Politikat e BE dhe Kohezioni territorial	10
	2	Administrimi territorial, planifikimi dhe qeverisja territoriale	10
	3	Administrimi i te dhënave dhe metodat gjeoinformatike	10
Viti i dyte, Semestri i pare (3)	1	Instrumentet dhe metodat e vlerësimit të politikave	10
	2	Sipërmarrja dhe menaxhimi i bizneseve të vogla lokale	10
	3	Hartimi përgatitja dhe vlerësimi i projekteve	10
Viti i dytë, Semestri i dytë (4)	7	<i>Marketingu Territorial</i>	6
	8	Punimi i Diplomës	24
Totali 1+2+3+4			120

